

20131062547

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 44 paragrafi (1) të Ligjit për Siguri Private ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/2012), Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 23 korrik 2013, miratoi

VENDIM PËR PËRCAKTIMIN E PERSONAVE JURIDIK QË JANË TË DETYRUAR TË KENË SIGURIM PRIVAT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohen personat juridik që janë të detyruar të kenë sigurim privat.

II. SIGURIM PRIVAT TË PERSONAVE JURIDIK VEPRIMTARIA E TË CILËVE ËSHTË E LIDHUR ME TRAJTIMIN E MATERIALEVE RADIOAKTIVE OSE TË TJERA QË KA TË BËJË ME NJERËZIT DHE ME MJEDISIN DHE MATERIALE TË RREZIKSHME

Neni 2

Personat juridik në Republikën e Maqedonisë të regjistruar për veprimtari sipas Ligjit për mbrojtje nga rrezatimi jonizues dhe siguri ndaj rrezatimit, përveç detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj kanë sigurim fizik dhe teknik për të garantuar sigurinë e burimeve të rrezatimit jonizues nga qasje e paautorizuar e personave të paftuar në objektet gjatë transportimit dhe deponimit e mbetjeve radioaktive.

Personat juridik në Republikën e Maqedonisë të regjistruar për prodhim dhe qarkullim me shumicë me barëra dhe me pajisje farmaceutike dhe mjekësore në përputhje me Ligjin për barna dhe pajisje mjekësore, si dhe në pajtim me rregulloret e tjera në fushën e barnave dhe pajisjeve mjekësore, si dhe institucionet shëndetësore për kujdesin spitalor dytësor dhe terciar që kanë siguri fizike dhe teknike të objekteve dhe zonën përreth.

Personat juridik në Republikën e Maqedonisë të regjistruar për prodhimin dhe tregtinë me lëngje të ndezshme dhe gazrave të ndezshme vëllimi i të cilëve është më shumë se sa i përcaktuari me Ligjin për ruajtjen dhe mbrojtjen e lëngjeve të ndezshme dhe gazrave për të mbrojtur depot e tyre, tanket dhe rezervuarët me rrethojë të përcaktuar, kanë sigurim teknik, ndërsa duke përdorur edhe masa të tjera të nevojshme edhe siguri fizike, në pajtim me ligjin.

Personat juridik në Republikën e Maqedonisë të regjistruar për transportin e mallrave të rrezikshme, përveç detyrimeve të përcaktuara në Ligjin për transportin e mallrave të rrezikshme në trafikun me rrugë dhe hekurudhë, në vendin ku bëhet ngarkimi ose shkarkimi i mallrave të rrezikshme kanë siguri fizike dhe teknike.

III. SIGURIM PRIVAT I PERSONAVE JURIDIK AKTIVITETI I TË CILËVE ËSHTË LIDHUR ME TRAJTIM TË LËNDËVE DHE OBJEKTEVE ME NJË RËNDËSI TË VEÇANTË KULTURORE DHE HISTORIKE

Neni 3

Institucionet publike dhe muzetë private të themeluara në pajtim me Ligjin për Muzetë dhe Institucionet Publike të themeluara në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, veprimtaria e të cilave lidhet me trajtimin e lëndëve dhe objekteve me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike, si dhe lokalitetet arkeologjike dhe trashëgimi tjetër e paluajtshme kulturore kanë sigurimin fizik dhe teknik të trashëgimisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme.

IV. SIGURIM PRIVAT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE KUR ËSHTË NË INTERESAT PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Neni 4

Personat juridik në territorin e Republikës së Maqedonisë të regjistruar për kryerjen e veprimtarive në fushën e energjisë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Energji, për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë, përveç masave të tjera të sigurisë të përcaktuara me ligj dhe të përcaktuara me legjislacionin dytësor, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës për njerëzit dhe për të mbrojtur mjedisin, natyrën dhe bimët kanë siguri fizike dhe teknike.

Personat juridik në territorin e Republikës së Maqedonisë të regjistruar për kryerjen e veprimtarive në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm për popullatën dhe për nevojat teknologjike në pajtim me Ligjin për ekonomizim të ujërave kanë siguri fizike dhe teknike.

Personat juridik në Republikën e Maqedonisë të regjistruar për të kryer aktivitetet për mbrojtjen dhe menaxhimin e zonave me shumë qëllime, mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, ruajtjen e natyrës dhe trashëgimisë natyrore në zonat e mbrojtura dhe jashtë zonave të mbrojtura në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe në pajtim me rregulloret e tjera në fushën e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit jetësorë, natyrës dhe parqet kombëtare kanë sigurinë fizike dhe teknike në hapësira e objekteve me të cilat ekonomizojnë.

Ndërmarrja Publike Radio Televizioni i Maqedonisë dhe personat e tjerë juridik të regjistruar për kryerjen e veprimtarive me interes publik (mediet elektronike dhe të shkruara) në kushtet e përcaktuara me Ligjin për themelimin e ndërmarrjes publike Radiodifuzioni i Maqedonisë, Ligjin për veprimtari radiodifuzioni dhe Ligjin për komunikime elektronike kanë siguri fizike dhe teknike.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë dhe personat juridik të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë bankare në pajtim me Ligjin për Bankën Kombëtare të Republikës së Maqedonisë dhe Ligjin për Bankat kanë siguri fizike dhe teknike të objekteve, zonës përreth dhe transportit të parave dhe të vlerave.

V. Dispozita përfundimtare

Neni 5

Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi, pushon së qeni i vlefshëm Vendimi për përcaktimin e personave juridik që janë të detyruara të kenë sigurim të personave dhe pronës për nevoja personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/2010) pushon së qeni i vlefshëm.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr. 41-2999/1
23 korrik 2013
Shkup

Zëvendës i kryetarit të Qeverisë së
Republikës së Maqedonisë,
m-r **Vladimir Peshevski**, n.p.